



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN**

.....
Adresa: Lagjia "Qender" Poliçan ; Tel:036824200 ; Email: njvbashkiapolican@gmail.com

Nr. 1064/Prot
19

Poliçan, me 19.04 2017.

KONTRATE SUPERVIZIMI

Për objektin "Supervizim i punimeve me objekt: "Rehabilitim i zones pas pallateve te ish-mapos dhe rikualifikimi i fasadave te pallateve" "

Sot me date 19.04.2017 ne Polican lidhet kjo kontrate për supervizimi/ mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin : **"Supervizim i punimeve me objekt "Rehabilitim i zones pas pallateve te ish-mapos dhe rikualifikimi i fasadave te pallateve" (këtej e tutje referuar si kontratë)**

Neni I

Palet kontraktuese

Bashkia Polican me seli në Polican e përfaqësuar ligjërisht nga Kryetari i Bashkise Z.Adriatik Zotkaj (këtej e tutje referuar si Investitori) dhe operatori ekonomik Liliana Vllamasi me nr.License MK.0431/6 date 04.02.2013 me NIPT. K61905007L , si perfaqesues bashkimit te operatoreve Liliana Vllamasi dhe HMK-Consulting, sipas prokures se posatshme noteriale me Nr.1350Rep,Nr.374Kol date 18.04.2017

Neni 2

Baza ligjore

Ligji nr.139/2015 " Për Vetqeverisjen Vendore" Ligji Nr 8402 dt 10.09.1998 " Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" I ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit te Ministrave Nr 3 dt 15.02.2001 " Për mbikëqyrjen e kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 704 dt 29.10.2014 ;Per miratimin e manualit te tarifave per sherbim ne Planifikimin e Territorit projekti, mbikqyrje dhe kolaudim.



Neni 3

Objekti

Lidhet kontrata për caktimin e supervizorit të punimeve të ndërtimit për objektin: **“Supervizim i punimeve me objekt: “Rehabilitim i zones pas pallateve te ish-mapos dhe rikualifikimi i fasadave te pallateve”**”, Polican midis Investitorit Bashkia Polican e perfaqësuar nga Kryetari i saj Z.Adriatik Zotkaj dhe supervizuesit të punimeve bashkimit te operatoreve Liliana Vllamasi me nr.License MK.0431/6 date 04.02.2013 me NIPT. K61905007L dhe shoqeria HMK-Consulting shpk me Nipt L57129604Q”, perfaqesuar nga Z.Hekran Hoxholli , bashkim operatorësh i perfaqesuar nga Znj.Liliana Vllamasi sipas prokures se posatshme noteriale me Nr.1350Rep,Nr.374Kol date 18.04.2017 pasi u njoh me dokumentacionin perkates me vullnet të lirë pranon dhe merr përsiper detyren e ngarkuar të mbikëqyresit të punimeve të ndërtimit për objektin **“Supervizim i punimeve me objekt: “Rehabilitim i zones pas pallateve te ish-mapos dhe rikualifikimi i fasadave te pallateve”** me punimet që do të kryhen nga operatori ekonomik fitues

Neni 4


Cmimi i kontratës

Cmimi i kësaj kontrate fiksohet ne **19 820** (nentembdhjete mije e teteqind e njetete) leke pa T.V.SH dhe **23 784** (njetet e tre mije e shtateqind e tetedhjete e kater) leke me TVSH.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrat e investitorit Bashkia Polican

- 1.Të kërkojë në cdo kohë informacion mbi bazen e akteve të përpiluara nga supervizori i punimeve sipas ecurisë dhe fazave konkrete brënda grafikut të punimeve.
- 2.Të zevëndesojë supervizorin e punimeve kur vëren mangesi serioze në punen e tij,duke bërë zgjidhjen e njëanshme të kontratës i zhveshur nga cdo detyrim.
- 3.Të lirojë e të dorëzojë sheshin e ndërtimit për punimet që do të realizohen në afatin e përcaktuar në kontratën e sipermarrjes.
- 4.Të vërë në djeni supervizorin për të gjitha ndryshimet që mund të pasojë dokumentacioni teknik si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga supervizorin i punimeve.
- 5.Të bëjë pagesen e plotë të mbikëqyresit në bazë te V.K.M.Nr 444 dt 05.09.1994 në rastin konkret për shumën **23 784 (njetet e tre mije e shtateqind e tetedhjete e kater) leke me TVSH** të përcaktuar në këtë kontratë dhe sipas situacineve të dorëzuara.
- 6.Të informohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e mbikqyresit të punimeve për ecurine e punimeve dhe problematikat konkrete.



Neni 6


Të drejtat dhe detyrimet e supervizorit të punimeve

1. Të fillojë punë pas dorëzimit të sheshit tek sipermarrësi.
2. Të marrë shpërblim pas cdo situacioni të dorëzuar tek sipërmarrësi.
3. Të kërkojë prej investitorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik që ka lidhje me objektin ku punohet.
4. Te mbajë konform udhëzimeve të gjithë dokumentacioni e nevojshëm dhe ta ketë atë disponibel në cdo moment që i kërkohet investitorit.
5. Të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për vërtetësinë e dokumentacionit që pasqyrohen atje
6. Të verifikojë që në fillim të punimeve dokumentacionin teknik, licensën e sipermarrësit (Firmes Fituese), verifikimin e sheshit të ndërtimit njohjen e kontratave dhe pas verifikimit harton dokumentacionin përkatës e cila I bashkangjitet dosjes së tenderit
7. Të bëjë informim me shkrim cdo 15 ditë për të gjitha rastet dhe masat e mara për zbatimin e projektit duke patur parasysh cilësinë e punimeve të bëjë verifikimet në rast difekte punimesh.
8. Të mos lejoje asnje punim që të realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij duke i pasqyruar në dokumentacionin përkatës. Në rast të kundërt duhet të marrë iniciativën që I lejon ligji për të rivendosur situatën teknike të pranuar nga ligji.
9. Të kërkojë prej sipërmarrësit të gjitha aktet e nevojshme që kanë të bëjnë me përfundimin e punimeve kur së bashku me sipërmarrësin dhe kolaudatorin mbajnë process-verbalin për dorëzimin e dosjes së punimeve.
10. Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga firma fituese dhe pas kësaj këto vleresohen te vlefshme per tu bërë pagesa përkatëse.
11. Pas përfundimit te kolaudimit përcakton vlerën përfundimtare të objektit që I jepet per likudim invesitorit (Bashkise Polican)
12. Të kërkojë prej investitorit plotësimin e të gjitha kërkesave te parashikuara në kontratën e sipërmarrjes midis investitorit dhe sipërmarrësit që lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipërmarrësit si dhe kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë.
13. Te ndjekë nga afër cdo punim që behet prej sipërmarrësit në objekt.
- 14 Të respektojë me përpikmëri dispozitat ligjore në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Neni 7

Sanksionet

Shkelja e nenit 5,6,7,8,9,10,11 të ligjit nr 8402 dt 10.09.1998 I ndryshuar përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas ligjit.



Afati i gjobes është brenda 5 ditëve pas kalimit të këtij afati paguhet kamate 2% vonesë deri në një muaj

Më vonë vendimi ekzekutohet ne rrugë gjyqësore sipas ligjit ne Gjykatën e Shkalles se Pare rrethit Berat.

Palët pasi e lexojnë kontratën dhe e gjejnë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e nenshkruajnë Palet pasi e lexojne mosmirëkuptimin palët e përfshira ne këtë kontratë I drejtohen gjykatës se Shkalles se pare te rrethit Vlorë.

Neni 8

Depozitat

Kjo kontrate fiton fuqinë e nevojshme juridike e detyruese pas nenshkrimit të saj prej pales pjesëmarrëse.

Kjo kontratë përpilohet në pesë kopje, nje kopje i depozitohet pranë protokoll arshivës, një kopje arshivohet në dosjen e prokurimit,një i vihet ne dispozicion Drejtorise së Finances,nje kopje i jepet sipërmarrësit të punimeve si dhe një kopje i vihet në dispozicion mbikëqyresit te punimeve

**INVESTITORI
BASHKIA POLICAN
KRYETARI**

ADRIATIK ZOTKAJ



**MBIKQYRESI I PUNIMEVE
JV "Liliana Vllamasi" pf & "HMK-Consulting" shpk**

Perfaqesuar nga Znj. Liliana VLLAMASI

